

**Programi i Pajtueshmërisë i Operatorit të
Sistemit të Shpërndarjes**

("Programi i Pajtueshmërisë")

Prishtinë, 12 shkurt 2020



Përmbajtja

HISTORIKU	3
PROGRAMI I PAJTUESHMËRISË I OPERATORIT SISTEMIT TË SHPËRNDARJES	4
1. HYRJE	4
2. BAZA LIGJORE.....	5
3. OBJEKTIVA E PROGRAMIT	5
4. ZYRTARI I PAJTUESHMËRISË	5
4.1. DETYRAT E PËRGJITHSHME TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË.....	6
4.2. PËRGJEGJËSITË E ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË NDAJ RREGULLATORIT.....	6
4.3. PËRGJEGJËSITË E ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË NDAJ MENAXHMENTIT TË OSSH-SË.....	6
4.4. DETYRAT OPERATIVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË.....	7
5. PROCESET E BRENDSHME	7
6. MASAT PËR NDALIMIN E DISKRIMINIMIT	8
7. INFORMACIONI I NDJESHËM KOMERCIAL	9
8. INFORMACIONI PUBLIK	11
9. ZBATIMI DHE MONITORIMI I PROGRAMIT TË PAJTUESHMËRISË	11
10. RAPORTI VJETOR I PROGRAMIT TË PAJTUESHMËRISË	12
11. NDRYSHIMI	12
12. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	13
13. HYRJA NË FUQI	13



Historiku

Deri në vitin 2013 sektori i energjisë në Republikën e Kosovës ka qenë i organizuar vertikalisht. Kjo mënyrë e organizimit është udhëhequr nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe nga Korporata Energjetikë e Kosovës (KEK), e cila ka qenë përgjegjëse për gjenerimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike, kompani publike me 100 % të aksioneve shtetërore.

Me datë 8 Maj të vitit 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës ka mundësuar privatizimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike.

Partneriteti Çalik-Limak formuan kompaninë “Çalik-Limak Energy sh.a”. Partneriteti Çalik-Limak fillojë të operojë nën titullin “Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KKDFE ose ang. KEDS)” me datë 03 Maj 2013, pasi që edhe u licencua nga Zyra e Rregullatorit për Energji (në vijim ZRRE) për operim të sistemit të shpërndarjes dhe furnizim me energji elektrike në Kosovë.

Në vitin 2014 kanë filluar aktivitetet në lidhje me shturjen ligjore dhe funksionale të kompanisë. Në fund të vitit 2014 në bazë të kërkesave ligjore, detyrimeve të marrëveshjes së privatizimit dhe me udhëzimet e Zyrës së Rregullatorit për Energjisë është realizuar me sukses shturja funksionale dhe ligjore e shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.

Shturja ligjore rezultojë në formimin e kompanisë të furnizimit publik me energji elektrike “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a (në vijim, KESCO) nga ana e kompanisë amë Kosova Çalik-Limak Energy sh.a. Ndarja e funksioneve ndërmjet KEDS dhe KESCO u bë duke respektuar kushtet e parapara në licencat reciproke dhe planit të veprimit të shturjes ligjore.

ZRRE-ja me vendimin numër V_670_2014 ka lejuar transferimin e licencës së furnizuesit publik të energjisë elektrike nga KEDS te kompania e KESCO-s. KESCO ka filluar të operojë



në bazë të licencës së furnizuesit publik të energjisë elektrike nga data 1 Janar 2015. KEDS ka transferuar në KESCO të gjithë pasuritë, kontratat, punonjësit dhe detyrimet dhe të drejtat në lidhje me funksionet e Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike.

Trajtimi i shërbimeve të përbashkëta për të dy kompanitë e licencuara është paraparë në planin e veprimit të shthurjes ligjore që të themelohen si njësi administrative në kuadër të OSSH-së dhe të kryejnë shërbime edhe për furnizuesin publik me energji elektrike (FPEE-në), në baza kontraktuale. Trajtimi i shërbimeve të përbashkëta është lejuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji me vendimin numër V_619_2014 dhe udhëzimin përkatës. Sipas Nenit 6 paragrafit 2 të Udhëzuesit për Shthurje Ligjore të KEDS/Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe KEDS Furnizuesit Publik *“Shërbimet e përbashkëta do të kryhen nga OSSH ose kompania e cila e ka në pronësi OSSH, bazuar në marrëveshjen e cila do të lidhet për shërbimet e përbashkëta në mes të OSSH-së dhe FPEE-së. Kushtet e marrëveshjes, pagesat dhe elementet tjera do të përcaktohen në marrëveshjen e cila para nënshkrimit do t’i dërgohet ZRRE-së për aprovim”*

Qendra e Thirrjeve është transferuar në KESCO dhe vazhdon të jetë funksion i saj.

Programi i Pajtueshmërisë i Operatorit Sistemit të Shpërndarjes

1. Hyrje

1. Qëllimi kryesor i Programit të Pajtueshmërisë (në vijim, PP) është të sigurojë një kornizë ligjore në mënyrë që aktivitetet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (në vijim, OSSH) në tërësi si edhe punonjësit dhe menaxhimi i OSSH-së të respektojnë parimet e objektivitetit, transparencës dhe mos diskriminimit.
2. PP synon të sigurojë qasje të barabartë dhe transparente të të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike për shërbimet e ofruara nga OSSH-ja dhe përcakton masat për parandalimin e sjelljes diskriminuese dhe detyrimet përkatëse të punonjësve të OSSH-së.



2. Baza Ligjore

1. Programi i Pajtueshmërisë i OSSH-së është hartuar në bazë të nenin 27, paragrafi 6 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr.05/L-085) dhe po ashtu nenit 21 të licencës së OSSH të Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KEDS), me numër licence ZRRE/Li/Tr_06/17.
2. PP i paraqitet për miratim Zyrës së Rregullatorit për Energji përpara hyrjes në fuqi.

3. Objektiva e Programit

1. Në zbatim të dispozitave të nenin 27 paragrafi 6 të Ligjit për Energji Elektrike, OSSH-ja, përcakton brenda kornizës së PP:
 - 1.1. Masat për eliminimin e sjelljeve diskriminuuese ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të energjisë elektrike dhe përdoruesve të rrjetit;
 - 1.2. Të drejtat dhe përgjegjësitë (detyrimet specifike) e punonjësve të operatorit sistemit të shpërndarjes për të përmbushur objektivin e Programit; si dhe
 - 1.3. Mekanizmin për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programit.

4. Zyrtari i Pajtueshmërisë

1. Zyrtari i Pajtueshmërisë (në vijim, ZP) është person fizik ose juridik i emëruar nga Bordi Ekzekutiv i OSSH-së, dhe i nënshtrohet miratimit nga ZRRE-ja.
2. ZRRE-ja mund të refuzojë miratimin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë për shkak të mungesës së pavarësisë ose aftësisë profesionale, dhe në çdo kohë mund të kërkojë zëvendësimin e ZP, të caktuar për të njëjtat arsye.
3. ZP i OSSH-së duhet të jetë i pavarur dhe të ketë qasje në të gjitha informatat e OSSH-së dhe të ndonjë ndërmarrjeje të ndërvarur të tij, për të përmbushur detyrën e tij.



4.1. Detyrat e Përgjithshme të Zyrtarit të Pajtueshmërisë

Detyrat e përgjithshme të ZP-së janë hartimi, zhvillimi dhe implementimi i PP-së. ZP-së do të angazhohet në hartimin e programit të pajtueshmërisë dhe identifikimin e të gjitha masave për të siguruar respektimin e parimeve të pajtueshmërisë. Sa i përket zhvillimit të PP-së, ZP-së përcakton objektivat dhe masat që do të merren për të korrigjuar dhe përshtatur PP-së në vazhdimin e përmirësimit të proceseve. Gjithashtu Zyrtari i pajtueshmërisë monitoron dhe vlerëson proceset, i krahason ato me kërkesat e përcaktuara në ligj dhe rregullore dhe harton raporte për rezultatet.

4.2. Përgjegjësitë e Zyrtarit të Pajtueshmërisë ndaj Rregullatorit

1. Përveç detyrave të përgjithshme, ZP ka edhe përgjegjësit në vijim, në raport me Rregullatorin:

- 1.1. Zyrtari i Pajtueshmërisë është përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë si dhe për dorëzimin e raporteve të pajtueshmërisë tek ZRRE bazuar në Doracakun e Raportimit të ZRRE-së. ZP do të raportojë për shkallën e pavarësisë së OSSH-së dhe për çdo shkelje në lidhje me zbatimin e PP-së.
- 1.2. ZP, do të përgatis dhe dorëzojë në ZRRE raport vjetor të pajtueshmërisë për vitin paraprak, duke përcaktuar masat e marra për të zbatuar PP-së, dhe zbatimin të tyre nga OSSH në lidhje me arritjen e objektivave të tij.
- 1.3. ZP është përgjegjës për çdo përshtatje ose ndryshim të PP me procedurën e rënë dakord me ZRRE-në.

4.3. Përgjegjësitë e Zyrtarit të Pajtueshmërisë ndaj Menaxhmentit të OSSH-së

1. ZP-së mund të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e menaxhmentit ose organeve administrative të OSSH-së, të bordit të drejtorëve dhe në mbledhje të aksionarëve, dhe mund të jetë i pranishëm në të gjitha takimet që trajtojnë çështjet që lidhen me organizimin, qasjen në rrjet, tarifën, procedurat e qasjes së palës së tretë, alokimin e kapaciteteve dhe procedurat e menaxhimit të kongestionit, transparencës, balancimit, legjislacionit sekondar etj. Ndër të tjera, ZP do të:



- 1.1. Raportojë për përmbushjen e Programit të Pajtueshmërisë tek menaxhmenti i lartë i OSSH-së;
- 1.2. Ofrojë këshilla dhe informacione menaxhmentit dhe organeve të OSSH-së me qëllim të lehtësimit të përmbushjes së detyrimeve sipas PP-së;
- 1.3. Përgatis propozime për sanksionet disiplinore tek menaxhmenti i lartë i OSSH-së në rast të shkeljes së PP-së.

4.4. Detyrat Operative të Zyrtarit të Pajtueshmërisë

1. Zyrtari i Pajtueshmërisë, përveç detyrave të sipërpërmendura ka edhe disa detyra operative, të cilat janë:
 - 1.1. Monitorimi i zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë në lidhje me pajtueshmërinë e punonjësve në menaxhimin e OSSH-së dhe ndërmarrjen e masave përkatëse;
 - 1.2. Monitorimi i efektivitetit të praktikave, procedurave dhe sistemeve të miratuara nga OSSH në përputhje me Programin e Pajtueshmërisë;
 - 1.3. Pranimi dhe hetimi i çdo ankese nga punonjësit/konsumatorët në rast të diskriminimit aktual ose të dyshuar dhe shkeljeve të Programit të Pajtueshmërisë;
 - 1.4. Rekomandimi dhe këshillimi për veprimet korrigjuese që hetimi i ankesave ka treguar se është i nevojshëm ose i dëshirueshëm;
 - 1.5. Organizimi i trajnimeve për punonjësit ekzistues dhe të rinj të OSSH-së për çështjet e pajtueshmërisë; etj.

5. Proceset e Brendshme

1. OSSH-ja do të siguroj që proceset e brendshme operative dhe organizative të mos ofrojnë trajtim preferencial të pjesëmarrësve të veçantë të tregut në dëm të pjesëmarrësve të tjerë të tregut.
2. OSSH-ja do të monitoroj dhe siguroj trajtim të barabartë të pjesëmarrësve në tregun e energjisë në aktivitetet/proceset e mëposhtme, dhe jo vetëm:
 - 2.1. Planifikim dhe zhvillim të rrjetit të shpërndarjes;



- 2.2. Funkcionim dhe mirëmbajtje të sistemit të shpërndarjes;
 - 2.3. Faturim;
 - 2.4. Ndërprerje ose reduktim të furnizimit me energji elektrike;
 - 2.5. Eliminim të defekteve;
 - 2.6. Kyçje të furnizuesve;
 - 2.7. Ndërrim të furnizuesit;
 - 2.8. Kyçje të shfrytëzuesve në rrjetin e shpërndarjes;
 - 2.9. Matje, lexim, kontroll, monitorim, ndryshim dhe mirëmbajtje të pajisjeve matëse;
 - 2.10. Menaxhim të të dhënave nga pajisjet matëse;
 - 2.11. Të tjera.
3. Zyrtari i Pajtushmërisë do të raportojë në Rregullator për proceset e sipërpërmendura, kur kjo kërkohet nga Rregullatori.
 4. Në pajtim me Nenit 28 të Ligjit për Energjinë elektrike, OSSH, përveç tjerash, do të veprojnë në pajtushmëri me Kodin e Rrjetit të transmetimit, Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes dhe të gjitha Kodet dhe Rregullat tjera në fuqi.

6. Masat për Ndalimin e Diskriminimit

1. Me qëllim të sigurimit të objektivitetit, transparencës dhe parandalimit të diskriminimit në përmbushjen e detyrimeve për ofrimin e shërbimeve në territorin e Republikës së Kosovës, OSSH-ja do të zbatojë rregullat e mëposhtme:
 - 1.1. Do të lejojë shfrytëzimin, përdorimin qasjen në rrjet të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - 1.2. Brenda fushëveprimit të saj, do të ndërmarrë masa për të hequr çdo lloj diskriminimi në tregun e energjisë elektrike;
 - 1.3. Asnjë pjesëmarrës në treg nuk do të marrë trajtim preferencial në dëm të ndonjë pjesëmarrësi tjetër të tregut të energjisë elektrike;
 - 1.4. Vendimet e marra nga OSSH-ja do të jenë të qarta, koncize dhe të vërtetuara në detaje, brenda afateve përkatëse;



- 1.5. Ndërprerja e furnizimit me energji elektrike do të bëhet në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- 1.6. OSSH do të eliminojë defektet në rrjetin e shpërndarjes sa më shpejt të jetë e mundur, duke marrë parasysh kushtet atmosferike, shtrirjen e defektit, gjendjen e terrenit dhe bashkëpunimin me institucione dhe qytetarë;
- 1.7. OSSH do të kryejë detyrimet e veta në procesin e ndryshimit të një furnizuesi në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- 1.8. Të gjithë furnizuesit do të marrin nga OSSH të njëjtin informacion në të njëjtën kohë, etj.

7. Informacioni i Ndjeshëm Komercial

1. OSSH-ja duhet të sigurojë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm komercial të marrë gjatë aktiviteteve funksionale dhe komerciale dhe duhet të marrë masat e nevojshme për të ruajtur informacionin e ndjeshëm komercial.
2. Informacioni i ndjeshëm komercial nënkupton:
 - 2.1. Informacionin në lidhje me menaxhimin, funksionimin dhe zhvillimin e sistemit shpërndarjes, përveç informacionit që konsiderohet publik sipas legjislacionit;
 - 2.2. Informacionin që përmban sekrete tregtare dhe informacione të tjera të ndjeshme komerciale të pranuar nga OSSH-ja;
 - 2.3. Informacione të tjera të natyrës komerciale, financiare ose teknike të cilave iu vijnë drejtuesve ose punonjësve të OSSH gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre profesionale dhe janë informacione të ndjeshme komerciale dhe mund të merren nga pjesëmarrës të ndryshëm që ofrohet si një avantazh konkurrues në treg;
 - 2.4. Informacionin e klasifikuar si konfidencial dhe marrëveshjet reciproke të nënshkruara nga OSSH-ja;
3. OSSH nuk duhet të zbuloj informacionin e ndjeshëm komercial tek ndonjë palë e tretë përveç rasteve kur:



- 3.1.Zbulimi i informacionit kërkohet shprehimisht me ligj, duke siguruar që ky zbulim të kryhet në mënyrë të përcaktuar me ligj;
 - 3.2.Një pëlqim paraprak me shkrim për zbulimin e informacionit jepet nga personi ndaj të cilit OSSH është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit;
 - 3.3.Kur informacioni nuk është më konfidencial për shkak të zbulimit të tij siç kërkohet me ligj.
4. OSSH-ja duhet të ruaj informacionin konfidencial të cilësuar si të tillë sipas kontratave me furnizuesit e produkteve dhe shërbimeve. Këta furnizues duhet të sigurojnë që drejtuesit dhe punonjësit e tyre që e marrin këtë informacion konfidencial nga OSSH-ja duhet të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me këtë informacion dhe nuk e zbulojnë atë tek ndonjë palë e tretë përveç nëse specifikohet ndryshe në kontratë.
 5. Detyrimi për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit duhet të vazhdojë gjatë gjithë kohës së marrëdhënieve kontraktuale si dhe pas mbarimit të tyre, derisa informacioni konfidencial të zbulohet publikisht në mënyrë ligjore. Kështu:
 - 5.1. Drejtuesit dhe punonjësit e OSSH-së duhet të sigurojnë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm komercial të cilët e kanë në dispozicion për shkak të detyrës profesionale;
 - 5.2. Çdo dokument që përmban informacion të ndjeshëm komercial duhet të shënohet si i tillë në faqen e parë;
 - 5.3. Të drejtat e qasjes në sistemet e informacionit dhe bazën e të dhënave të OSSH-së si dhe dosjet e përbashkëta duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të mos favorizojnë pjesëmarrësit ose përdoruesit e rrjetit;
 - 5.4. Në përputhje me kërkesat e transparencës OSSH-ja duhet të sigurojë që të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të trajtohen në mënyrë jo diskriminuese dhe me kushte të njëjta kur ofrohen informacione që kanë lidhje me aktivitetet e OSSH-së. Nëse ndonjë informacion i ndjeshëm komercial duhet të zbulohet, atëherë duhet të sigurohet që ky informacion është zbuluar për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit në mënyrë të njëjtë duke e publikuar atë në faqen e internetit të OSSH;



5.5. Kontratat e punësimit me punonjësit e OSSH-së duhet t’ju ofrojë punonjësve detyrimet që kanë lidhje me konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm komercial. Çdo prishje e detyrimit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm komercial siç kërkohet me këtë Program edhe me kontratat në fjalë, mund të quhet shkelje e detyrimeve të punonjësve dhe mund ti jap OSSH-së të drejtën për shqiptimin e masave disiplinore.

8. Informacioni Publik

1. Informacioni publik nënkupton çdo informacion që njihet se ka karakter publik sipas legjislacionit në fuqi. Informacioni publik duhet të vendoset në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve, përdoruesve të rrjetit dhe palëve të tjera të treta.
2. OSSH-ja duhet të publikojë në faqen e internetit informacionet e mëposhtme, dhe jo vetëm:
 - 2.1. Rregullat dhe kodet për operimin e sistemit të shpërndarjes;
 - 2.2. Metodologjinë Tarifore për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes;
 - 2.3. Plane zhvillimore afatmesme dhe afatgjate të sistemit të shpërndarjes që mbulojnë periudhën prej së paku pesë (5) vite respektivisht dhjetë (10) vite;
 - 2.4. Informacione të përgjithshme mbi funksionimin e sistemit të shpërndarjes etj.

9. Zbatimi dhe Monitorimi i Programit të Pajtuëshmërisë

1. Dispozitat e këtij Programi janë të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OSSH-së.
2. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OSSH-së duhet të jenë të informuar për Programin e Pajtuëshmërisë dhe duhet ta zbatojnë atë.
3. Drejtuesit e OSSH-së dhe punonjësit duhet të udhëzohen rregullisht për zbatimin e Programit (të paktën një herë në vit). Këto udhëzime duhet të jepen nga Zyrtari i Pajtuëshmërisë.



4. Nëse drejtuesit dhe punonjësit e OSSH-së vihen në dijeni për shkeljen e ndonjë dispozite të Programit, drejtuesit dhe/ose punonjësit duhet të informojnë menjëherë Zyrtarin e Pajtueshmërisë.
5. Shkelja e ndonjë dispozite të Programit mund të cilësohet si shkelje e detyrimeve nga drejtuesit dhe punonjësit dhe mund ti japë OSSH-së të drejtën për të zbatuar veprimet disiplinore sipas dispozitave të përcaktuara në aktet ligjore, kontratat dhe aktet e brendshme të kompanisë.
6. Monitorimi i vazhdueshëm për zbatimin e Programit kryhet nga Zyrtari i Pajtueshmërisë. Zyrtari i Pajtueshmërisë do të monitorojë respektimin e Programit të Pajtueshmërisë dhe detyrimet ligjore që përmbahen në të.
7. Në rast ndryshimi ose amendamenti të Programit, Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të njoftojë sa më shpejtë që të jetë e mundur drejtuesit e OSSH-së dhe punonjësit për përmbajtjen e këtyre ndryshimeve.

10. Raporti Vjetor i Programit të Pajtueshmërisë

1. ZP do të përgatisë raport vjetor mbi masat e marra në vitin paraprak për zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë.
2. ZP është i obliguar të dorëzoj raportin e pajtueshmërisë tek bordi ekzekutiv i KEDS-it deri në fund të muajit janar të vitit relevant. Bordi ekzekutiv i KEDS-it duhet të miratojë raportin jo më larg se fundi i muajit shkurt i vitit relevant.
3. Raporti vjetor i rishikuar nga menaxhmenti i OSSH-së, duhet t'i dorëzohet Zyrës së Rregullatorit për Energji, jo më vonë se 30 prill të vitit relevant. Në të njëjtën kohë, ZP do ta publikojë atë në një mënyrë që mundëson qasje nga distanca.

11. Ndryshimi

Procedurat për ndryshimin dhe modifikimin e këtij Programi të Pajtueshmërisë do të jenë të njëjta si për miratimin e tij dhe nuk mund të jetë i vlefshëm pa miratimin nga Rregullatori.



12. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Ky Program i Pajtueshmërisë shfuqizon “Programin e Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” (Programi i Pajtueshmërisë), i nxjerrë në Korrik 2015.
2. Zyrtari i Pajtueshmërisë, i caktuar sipas Programit të Pajtueshmërisë të vitit 2015 do të vazhdojë të kryej detyrat e tij deri në miratimin e zyrtarit të pajtueshmërisë nga Rregullatori, sipas Nenit 4 paragrafit 1 të këtij programi të pajtueshmërisë.

13. Hyrja në fuqi

Programi i Pajtueshmërisë do të jetë i vlefshëm për periudhë të pacaktuar dhe hynë në fuqi me datë 12.02.2020, kur edhe është aprovuar nga Bordi i ZRRE-së dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqe të KEDS-it dhe Rregullatorit.